

Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

Procesverbali i mbledhjes

Ref. 6/2012

Vendi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Data: 30 Janar 2012

Koha: 11:00 – 12:20

Pjesëmarrësit:

Robert Wright, *Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (kryesues);*
Gjylfidane Kadrijaj, *Drejtoresh e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK;*
Biljana Petrushevskaja-Trajkovska, *Country Manager, VISA CEMEA;*
Dukagjin Shylemaja, *Zëvendës Drejtor, TEB;*
Florin Lila, *Zëvendës Drejtor, PCB;*
Boryana Ivanova Mustafa, *Drejtoresh e Pagesave dhe Thesarit, NLB ;*
Zana Haxha, *Drejtoresh e Përgjithshme, SHBK;*
Edmond Jashari, *TEB;*
Edmond Murati, *MPMS;*
Makfire Osmani, *KUR Prishtina;*
Fatmir Rashica, *KEK;*
Blerta Krasniqi, *PCB;*
Afrim Gërguri, *PCB;*
Gresa Shehu, *RBKO;*
Erik Roka, *RBKO;*
Suzana Shehu, *BPB;*
Hamide Pacolli, *BEK;*
Lumni Rustolli, *BQK;*
Igballe Agushi, *BQK;*
Arzen Çavdarbasha, *BQK;*
Masar Baxhaku, *BQK;*

Munguan:

Përfaqësuesit e MF/Thesari, ATK dhe PTK (munguan pa njoftim paraprak) .

Takimi filloi në ora 11:00.

Znj. Gjylfidane Kadrijaj hapi takimin, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe njoftoi për praninë e përfaqësueses së VISA-së në këtë takim, njëkohësisht njoftoi dhe kërkoi miratim për agjendën e takimit.

Z. Robert Wright falënderoi përfaqësuesen e VISA-së për ardhjen e saj në takim, gjithashtu theksoi se në bazë të statistikave të fundit mbi instrumentet e pagesave vërehen përmirësime, porse mbetet akoma shumë punë për tu bërë në këtë drejtim.

Diskutimet dhe prezantimet

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

U konfirmua plotësimi i pikave të konkluzioneve dhe nga anëtarët u miratua njëzëri procesverbali i takimit paraprak të mbajtur më 14 Dhjetor 2011.

- **Prezantim nga ana e përfaqësuesve të VISA-së**

Përfaqësuesja e VISA-së, znj. Biljana Petrusevska-Trajkovska bëri prezantimin e programeve financiare edukative të VISA-së në vende të ndryshme të botës. Ajo tregoi për sukseset që kanë treguar këto programe duke rritur vetëdijesimin e njerëzve për përdorim të transaksioneve elektronike, e sidomos rëndësia që i është dhënë moshave të reja gjatë këtyre programeve.

Znj. Petrusevska-Trajkovska në mënyrë më të detajuar sqaroi programin që VISA ka zhvilluar në shtetet në rajon duke vënë theksin veçanërisht në rastin e Bosnjës në të cilën ka qenë e përfshirë edhe vet. Tregoi për suksesin dhe që ka pasur programi dhe mënyrat se si është realizuar.

U vendos që rasti i Bosnjës të merret si referim dhe për Kosovën dhe me ndihmën e VISA-së të zhvillohet edhe në Kosovë program i ngjashëm me Bosnjën. Përfaqësuesja e VISA-së tha që buxheti i tyre për vitin 2012 është i aprovuar, ndërsa tha se vetëm nga viti 2013 e tutje mund të ndahen mjete edhe për programet e tyre në Kosovë.

- **Informim i shkurtër i nëngrupit për standardizim të faturës dhe “web service”**

Nën-grupi punues edhe njëherë njoftoi për aktivitetin e tyre, për kontaktet me kompani të ndryshme (si me ato publike edhe me kompani të teknologjisë informative) në lidhje me standardizimin e faturës (*opsion i tretë më i avancuar, krahasuar me Kos Giro dhe UNIREF*), dhe mundësinë e krijimit të një “web service”. U tha që një numër shumë i vogël i kompanive publike aktualisht janë të përfshira në skemën e Kos-Giro për arsye të ndryshme e njëra nga to është edhe shpenzimet e larta për printim të faturës (fatura me ngjyra), ndërsa me krijimin e një fature të re standarde me shpenzime më të ulëta për printim, besohet që shumica nga këto kompani do të fillojnë përdorimin e faturës së re të standardizuar.

BQK-ja e përkrah nëngrupin në punën e tij në lidhje me standardizimin e faturës duke krijuar bazën e përshtatshme ligjore apo ndihmës në forma tjera. Ndërsa BQK inkurajon nëngrupin dhe pjesëmarrësit në përgjithësi në punën e tyre në krijimin e shërbimeve ueb dhe mënyrave tjera të pagesave elektronike.

Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm

- Rasti i programit edukativ të VISA-së për Bosnjë të merret si shembull dhe të shikohen mundësitë e zhvillimit edhe për Kosovë;
- Të ftohet VISA në një takim tjetër për të sqaruar më hollësisht detaje nga programi i saj në Bosnjë dhe mënyrën se si mund të zbatohet edhe në Kosovë;
- Pjesëmarrësit në ekip të mundohen të ndajnë mjete financiare në zhvillimin e këtij projekti dhe të kërkohet mbështetje financiare nga VISA;
 - *Analiza e mundësisë së rishikimit të buxhetit dhe përkrahjes sa më të shpejtë edhe për Kosovë, le të mbetet si hap i mirëpritur (ekip).*
- Vazhdimi i punës së ekipit menaxhues të projektit për reduktim të pagesave në para të gatshme, përmes nën-grupit punues me qëllim të finalizimit të standardizimit të faturës;
- BQK-ja do të përkujdeset për krijimin e bazës ligjore lidhur me standardizimin e faturës
- Të përgatiten statistikat mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave për vitin 2011 (*fundi i prillit, 2012*).